



MISIONI NDËRKOMBËTAR PËR VËZHGININ E ZGJEDHJEVE
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
Zgjedhjet lokale, 15 tetor 2017

DEKLARATË PËR GJETJET DHE PËRFUNDIMET PARAPRAKE

PËRFUNDIMET PARAPRAKE

Mbajtja e zgjedhjeve lokale më 15 tetor kontribuoi për përforcimin e besimit në procesin demokratik. Zgjedhjet u mbajtën në një ambient konkurrues, ku kandidatët, në përgjithësi, kishin mundësi të bëjnë fushatë pa kufizime dhe liritë themelore, në përgjithësi, u respektuan. Megjithatë, gjatë periudhës parazgjedhore kishte pretendime të besueshme për blerje të votave, presion mbi votuesit dhe pati raste të izoluar të dhunës. Në përgjithësi, mediat e monitoruara ofruan mbulim të paanshëm të garuesve dhe e lehtësuan mundësinë për debat politik. Përkundër sfidave organizative, administrata zgjedhore, në përgjithësi, siguroi që votuesit ta kenë mundësinë për ta ushtruar të drejtën e tyre të votës. Dita e zgjedhjeve, në përgjithësi, kaloi në mënyrë të rregullt, edhe pse u vërejtën disa parregullsi procedurale.

Korniza ligjore i ofron të drejtat dhe liritë fundamentale, duke përfshirë edhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe ofron një bazë të mirë për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike. Edhe pse me ndryshimet e bëra në vitet e fundit janë trajtuar një numër i rekomandimeve të mëparshme të OSBE/ODIHR-it dhe të Këshillit të Evropës, megjithatë kanë mbetur disa mangësi, duke përfshirë kufizimet për regjistrimin e kandidatëve të pavarur dhe të drejtat e kufizuara për mjete juridike. Ndryshimi i vonshëm i Kodit zgjedhor, që rezultoi me ndryshimin e përbërjes së Komisionit Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) është në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare.

Në përgjithësi, edhe pse KSHZ-ja arriti t'i administrojë zgjedhjet, diskutimet e saj për çështje kontestuese politike dhe përfshirja e panevojshme e sekretariatit të saj në punën operative, në disa raste rezultoi me tejkalimin e afateve kohore. Kjo e vonoi fushatën gjithëpërfshirëse të KSHZ-zë për edukim të votuesve. Disa rregulla të KSHZ-së ishin në kundërshtim me ligjin. Mbledhjet e KSHZ-së ishin të hapura për vëzhguesit, megjithatë shpeshherë vendimet e rëndësishme u morën në mbledhje të mbyllura. Vetëm disa komisione të nivelit të mesëm ndërmorrën iniciativa për ta përmirësuar transparencën e punës së tyre. Pozitive ishin hapat që u ndërmorrën për ta lehtësuar të drejtën e votës për personat me pengesa.

Për këto zgjedhje janë regjistruar gjithsej 1.814.644 votues. Gjatë verifikimit onlajn dhe personal të listave zgjedhore u kërkuar vetëm një numër i vogël i ndryshimeve. Si rezultat i kësaj, shumë bashkëbisedues të vëzhguesve ndërkombëtarë vërejtën besim të shtuar në integritetin e regjistrimit të votuesve, kurse disa të tjerë vazhduan të shprehin shqetësim për këtë, duke përfshirë edhe implementimin e kërkesës për vendbanim.

Pas një procesi inkluziv të regjistrimit, 19 parti politike dhe koalicione, si dhe 65 grupe votuesish, paraqitën gjithsej 258 kandidatë për kryetarë të komunave dhe 370 lista me kandidatë për këshillat komunalë. Votuesve iu ofruan një varg mundësish për të zgjedhur, dhe në shumë komuna pati numër të madh të garuesve.

Përbërja e KSHZ-së e përmbushi kërkesën për përfaqësim gjinor prej 30 për qind në administratën zgjedhore. Megjithatë, kjo nuk është respektuar gjithmonë në nivelet më të ulëta. Jo të gjitha listat me kandidatë e respektuan kërkesën ligjore për balanc gjinor, megjithatë ato u regjistruan. Çështjet që

kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e grave në jetën publike nuk u trajtuan në fushatë.

Fushata është e rregulluar në mënyrë gjithëpërfshirëse me ligj dhe në përgjithësi ofron kushte për terren të barabartë për garim. Fushata u zhvillua në një ambient ku liritë fundamentale për tubim dhe liri të shprehjes u respektuan në përgjithësi. Megjithatë, kishte disa incidente të izoluar, të motivuara politikisht, që përfshinin sulme ndaj shtabeve zgjedhore dhe dhunë ndaj një kandidati. Partitë më të mëdha bënë fushatë për çështjet shtetërore të stabilitetit dhe të integritetit, si dhe për çështjet e shërbimeve komunale dhe infrastrukturës.

Edhe pse rregullat për financimin e fushatës janë përmirësuar në vitet e fundit, në përputhje me rekomandimet e mëparshme, ato nuk sigurojnë transparencë të plotë adekuate për shkak të mungesës së kërkesës për revizion të raporteve të përkohshme, si dhe për shkak të kompetencave të pamjaftueshme për mbikëqyrje të Entit shtetëror për revizion. U dorëzuan vetëm një përqindje e vogël e raporteve të përkohshme.

Monitorimi i mediave nga ana MVZ-së së OSBE/ODIHR-it tregoi se mediat publike u ofruan të gjithë kandidatëve minutazh pa pagesë në periudhën me shikim më të madh, mirëpo vetëm një numër i vogël i kandidatëve e shfrytëzuan atë. Dy partitë më të madhe dominuan në reklamimin me pagesë në mediat private. Debatet televizive ishin të organizuara mirë, megjithatë, jo të gjithë kandidatët e ftuar morën pjesë në to. Organi mediatik që është përgjegjës për të siguruar mbulim të balancuar dhe të paanshëm mediatik, inicioi gjashtë procedura kundërvajtëse për shkelje nga ana e mediave.

Marrëdhëniet ndëretnike luajtën rol në këto zgjedhje. Edhe pse disa parti kërkuan vota përtej kufinjve etnikë, shumica e listave me kandidatë e pasqyruan përbërjen etnike të komunës së caktuar. Janë vërejtur disa raste të fushatës konfrontuese ndërmjet kandidatëve që i takojnë bashkësisë së njëjtë.

Korniza ligjore nuk ofron plotësisht mjete efektive ligjore për kontestet zgjedhore, që është në kundërshtim me përkushtimet e OSBE-së. KSHZ-ja pranoi vetëm disa ankesa deri në ditën para mbajtjes së zgjedhjeve. Edhe pse u paraqitën shqetësime për keqpërdorimin e burimeve administrative, blerjen e votave dhe presionet ndaj votuesve, vetëm disa ankesa janë parashtruar para organeve të tjera, disa nga të cilët janë duke u shqyrtuar. Një numër i bashkëbiseduesve e informuan MVZ-në e OSBE/ODIHR-it dhe Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës se nuk kishin besim në aftësinë e administratës zgjedhore dhe të gjykatave për t'i shqyrtuar në mënyrë të pavarur rastet që kanë të bëjnë me zgjedhjet.

Qasja e vëzhguesve qytetarë në të gjitha fazat e procesit kontribuoi për të pasur transparencë dhe ofroi vlerësim jopartiak të zgjedhjeve. Gjithsej 3.000 vëzhgues qytetarë u akredituan për t'i ndjekur procedurat në ditën e votimit.

Votimi i hershëm dhe dita e zgjedhjeve kaluan në mënyrë të rregullt në pjesën më të madhe të vendit. Personat e angazhuar në zgjedhje, në përgjithësi, në mënyrë efektive e lehtësuan votimin dhe iu përmbajtën procedurave të parapara. Megjithatë, vëzhguesit ndërkombëtarë vërejtën disa parregullsi që përsëriten, duke përfshirë votimin familjar/grupor dhe komprometimin e fshehtësisë së votës. Gjatë nxjerrjes së rezultateve, shumica e KZK-ve i ndoqën procedurat. Në 14 KZK, vëzhguesit nuk kishin qasje të mjaftueshme në procesin e futjes së të dhënave, gjë që e kufizoi transparencën. KSHZ-ja filloi t'i publikojë rezultatet preliminare një kohë të shkurtë pas mbylljes së vendvotimeve, që kontribuoi për transparencë, megjithatë rezultatet nuk ishin të ndara sipas vendvotimeve, që e kufizoi këqyrjen e tyre.

GJETJET PARAPRAKE

Sfondi

Pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2016, formimi i qeverisë u paraqit si sfidë. Partia Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) nuk arriti marrëveshje me partnerin e saj tradicional të koalicionit, Bashkimin Demokratik për Integrim (BDI).¹ Përkundrazi, BDI-ja dhe partitë e tjera të shqiptarëve etnikë e mbështetën Lidhjen Social Demokratike të Maqedonisë (LSDM), mirëpo kryetari i shtetit nuk u dha atyre mandatin për të formuar qeveri.

Më 27 prill, pas disa përpjekjeve të pasuksesshme, u zgjodh kryetari i Kuvendit, gjë që shkaktoi konfrontim në Kuvend dhe rezultoi me sulm ndaj deputetëve, duke përfshirë anëtarë të lartë të LSDM-së dhe të Aleancës për shqiptarët (ASH). Kriza politike u qetësua vetëm pasi kryetari i shtetit ia dha mandatin LSDM-së që të formojë qeveri, e cila u krijua më 31 maj, pas një vonese gjashtëmujore. Kjo vonesë rezultoi me shtyrjen e zgjedhjeve lokale.

Në korrik, qeveria i miratoi reformat ekonomike, gjyqësore dhe politike, si dhe planin për trajtimin e problemit me keqpërdorimin e burimeve administrative, presionin mbi nëpunësit publik, mbulimin jo të balancuar mediatik dhe mungesën e transparencës së administratës zgjedhore.²

Aspiratat shumëvjeçare të vendit për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE) dhe në NATO, përqindja e lartë në vazhdimësi e papunësisë dhe niveli i lartë i emigrimit e formuan sfondin e këtyre zgjedhjeve. Mënyra e mbajtjes së zgjedhjeve lokale nga shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it u konsiderua si test për besueshmërinë e qeverisë së re, që mund të ndikojë në proceset e integritetit në BE dhe NATO, që janë në zhvillim e sipër. Momentalisht, 55 nga 80 komuna udhëhiqen nga VMRO-DPMNE-ja, ndërsa LSDM-ja ka 4 kryetarë komunash me përkatësi partiake.

Korniza ligjore dhe sistemi zgjedhor

Zgjedhjet kryesisht janë të rregulluara me Kushtetutën e vitit 1991 dhe Kodin zgjedhor (KZ) të vitit 2006. Kushtetuta i përcakton të drejtat dhe liritë fundamentale, duke përfshirë edhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave, ndërsa KZ-ja në përgjithësi ofron një bazë të mirë për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike.³ Që nga miratimi i saj, KZ-ja ka pësuar disa ndryshime pozitive, shumica e të cilave janë në përputhje me rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisionit të Venedikut), të Këshillit të Evropës, veçanërisht sa i përket parimit për ndarjen e shtetit nga partia dhe rregullativës për financimin e fushatës. Megjithatë, kanë mbetur disa mangësi që kanë të bëjnë me një numër aspektesh ligjore, duke përfshirë kufizimet e panevojshme për regjistrimin e kandidatëve të pavarur dhe të drejtat e kufizuara për mjete ligjore.

Në vitin 2017, u futën edhe dy ndryshime kyçe në KZ: u ndryshua periudha e mbajtjes së zgjedhjeve lokale prej majit në tetor dhe Kuvendi u autorizua që ta ndryshojë përbërjen e Komisionit shtetëror zgjedhor (KSHZ).⁴ Rregullat e KSHZ-së i plotësojnë aspektet e ndryshme të legjislacionit zgjedhor.

¹ VMRO-DPMNE-ja i ka fituar zgjedhjet parlamentare në vitet 2006, 2008, 2011 dhe 2014, dhe ka udhëhequr me qeverinë deri në maj të vitit 2017.

² Raporti i grupit të ekspertëve të lartë ([Raporti i Pribes](#)) i shtatorit të vitit 2017, e vlerësoi gjyqësinë, zbatimin e ligjit dhe pavarësinë e institucioneve, dhe ofroi rekomandime për t'i trajtuar mangësitë e tyre sistematike.

³ Vendi nikoqir i ka ratifikuar të gjitha instrumentet kyçe ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut, duke përfshirë [Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave](#) të Kombeve të Bashkuara (KB) dhe [Konventën për të drejtat e personave me pengesa](#) (KDPP) të KB-ve.

⁴ Seksioni II.2.b i [Kodit për praktika të mira në çështjet zgjedhore \(Kodi për praktika të mira\)](#) i Komisionit të Venedikut rekomandon se “nuk duhet të lihet hapësirë që elementet fundamentale të ligjit zgjedhor... të ndryshohen më së paku një vjet para zgjedhjeve”.

Megjithatë, disa rregulla u miratuan ose u ndryshuan vonë, e disa ishin në kundërshtim me ligjin.⁵ Këto faktorë të kombinuar e sfiduan integritetin e procesit zgjedhor.

Zgjedhjet lokale mbahen çdo katër vjet për t'i zgjedhur kryetarët e komunave dhe këshillat komunalë në 80 komuna dhe në Qytetin e Shkupit. Këshilltarët zgjidhen me përfaqësim proporcional nëpërmjet listave të mbyllura me kandidatë. Kryetarët e komunave zgjidhen sipas sistemit të shumicës në dy rrethe zgjedhore. Balotazhet do të mbahen më 29 tetor, në ato komuna ku asnjë kandidat nuk ka fituar më shumë se 50 për qind të votave të hedhura. Për zgjedhjet për kryetarë të komunave, vetëm në rrethin e parë nevojitet pjesëmarrje e një të tretës së numrit të votuesve.

Administrimi i zgjedhjeve

Zgjedhjet lokale u administruan nga administrata zgjedhore në tre nivele që përbëhet nga KSHZ-ja, 80 Komisione zgjedhore komunale (KZK) dhe Komisioni zgjedhor për Qytetin e Shkupit, dhe 3,480 Këshilla zgjedhorë (KZ).

KSHZ-ja përbëhet nga nëntë anëtarë, tre nga të cilët janë gra. Sipas ligjit, tre anëtarë të KSHZ-së nuk kanë përkatësi partiake dhe zgjidhen nëpërmjet konkursit të hapur. Gjashtë anëtarët e tjerë e pasqyrojnë përbërjen politike të Kuvendit.⁶ Mandati pesëvjeçar i anëtarëve jopartiakë është i mbrojtur në mënyrë të arsyeshme, ndërsa të emëruarit partiakë, pas ndryshimeve të KZ-së që u bënë në shtator, duhet të ndërrohen që përbërja e KSHZ-së ta pasqyrojë përbërjen aktuale të Kuvendit. Në përputhje me këtë, më 22 shtator, anëtari i Lëvizjes BESA e zëvendësoi anëtarin e Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH).⁷ Madje, ndaj një anëtari aktual të KSHZ-së është ngritur padi për keqpërdorim të detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2013, gjë që e komprometon perceptimin publik të KSHZ-së.

KZK-të përbëhen nga pesë anëtarë, të zgjedhur në mënyrë të rastësishme nga radhët e nëpunësve shtetërorë në nivel komunal. KZ-të përbëhen nga dy anëtarë të emëruar politikisht dhe tre anëtarë jopartiakë. Disa anëtarë të KZ-ve u zgjodhën me vonesë. KSHZ-ja organizoi tre rrethe të trajnimeve në kohë dhe konsekuente për anëtarët e KZK-ve, të cilët pastaj i trajnuan KZ-të.

Përkundër sfidave organizative, administrata zgjedhore në përgjithësi siguroi që votuesit ta kenë mundësinë për ta ushtruar të drejtën e tyre të votës. Sipas ligjit, nga administrata zgjedhore kërkohet që punën e saj ta bëjë publike, mirëpo në praktikë, KSHZ-ja kishte mungesë të transparencës së mirëfilltë. Mbledhjet e KSHZ-së ishin të hapura për vëzhguesit, megjithatë shpeshherë vendimet e rëndësishme u morën në mbledhje të mbyllura. Publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve u vonua dhe jo të gjitha vendimet, rregullat dhe udhëzimet u vendosën në ueb-faqe. Poashtu, diskutimet e KSHZ-së për çështje kontestuese politike dhe përfshirja e panevojshme e sekretariatit të saj në punën operative, në disa raste rezultoi me tejkalimin e afateve kohore. Kjo e vonoi fushatën gjithëpërfshirëse të KSHZ-zë për edukim të votuesve.⁸ Kishte dallim në nivelin e transparencës së KZK-ve. Përderisa shumica prej tyre nuk zbatuan masa për ta përmirësuar transparencën e tyre, disa të tjera ndërmorrën iniciativa për ta rritur besimin në punën e tyre.⁹

⁵ Këtu përfshihen rregullat për regjistrimin e kandidatëve dhe procesi i ankesave dhe i apelimeve.

⁶ VMRO-DPMNE-ja dhe LSDM-ja kanë nga dy anëtarë secila, si parti që kanë numër më të madh të deputetëve në Kuvend, e më pas vijnë BDI-ja dhe Lëvizja BESA me nga një anëtar.

⁷ Mandati i anëtarit të KSHZ-së duhej të përfundojë në vitin 2020; ankesa e tij për shkarkimin që u parashtrua në Gjykatën Administrative dhe në Komisionin shtetëror për parandalimin e korrupsionit (KSHPK) u refuzua.

⁸ Për shkak të blerjes së vonshme të shërbimeve, fushata filloi më 2 tetor.

⁹ MVZ-ja e OSBE/ODHIR-it vërejti mungesë të transparencës në 30 KZK. Megjithatë, KZK-ja në Jegunovcë i informoi në mënyrë proaktive palët e interesuara për mbledhjet e saj dhe i shpërndaui procesverbalet. KZK-ja në Novo Sellë mirëmbante faqe në Facebook.

Pushtetet lokale janë përgjegjëse për financimin e zgjedhjeve. Komunitat, llogaritë e të cilave ishin të bllokuara me vendim gjyqësor për shkak të borxheve të papaguara, pranuan fonde nga buxheti shtetëror.¹⁰ Së paku 14 KZK kishin mungesë të hapësirave dhe të materialit dhe u ballafaquan me vështirësi plotësuese financiare.¹¹ Përkundër këtyre sfidave, KZK-të, në përgjithësi punuan në mënyrë profesionale.

KZ-ja parasheh kriter për përfaqësim gjinor prej 30 për qind në administratën zgjedhore, mirëpo kjo nuk u respektua në mënyrë konsekuente. Trembëdhjetë KZK nuk e plotësuan kuotën për përfaqësim gjinor.¹² Edhe pse nuk kërkohet me ligj, 28 për qind e KZK-ve kishin kryetare femër.

Për herë të parë, për ta lehtësuar të drejtën e votës për personat me pengesa, KSHZ-ja në bashkëpunim me shoqërinë civile i caktoi vendvotimet në të cilat kishte qasje për karrocë për invalidore dhe i vendosi këto informata onlajn. Poashtu disa vendvotime i furnizoi me shabllon me alfabet të Brejtit.

Regjistrimi i votuesve

Të gjithë qytetarët që kanë mbushur 18 vjet kanë të drejtë vote, përveç atyre që u është marrë kjo e drejtë ligjore me vendim gjyqësor. Ky kufizim është në kundërshtim me përkushtimet e OSBE-së dhe obligimet ndërkombëtare.¹³ Vetëm personat me adresë të paraqitur në komunën përkatëse dhe me letërnjoftim të vlefshëm ose me pasaportë biometrike janë përfshirë në regjistrin e votuesve.¹⁴

Regjistrimi i votuesve është pasiv. KSHZ-ja e mirëmban regjistrin e votuesve në bazë të të dhënave të nxjerra nga regjistri qytetar dhe ai i popullatës. Ajo e përditëson regjistrin e votuesve katër herë në vit, në bazë të të dhënave që i ofrojnë institucionet e ndryshme shtetërore.¹⁵ Një ditë pasi të shpallen zgjedhjet, bëhet edhe një përditësim plotësues i regjistrit të votuesve. KSHZ-ja ka të drejtë të bëjë inspektime të rastësishme për verifikim të saktësisë. Për këto zgjedhje, KSHZ-ja nuk e pa të nevojshme që të bëjë verifikim gjithëpërfshirës të regjistrit të votuesve.¹⁶

Gjatë këqyrjes publike, mbi 220.000 votues i kontrolluan të dhënat e tyre onlajn dhe personalisht, mirëpo vetëm 230 veta kërkuan të bëhen korrigjime.¹⁷ Një numër i kufizuar i ndryshimeve u kërkuan

¹⁰ Ministria për Financa ndau 30 milionë denarë (rreth 488.000 euro, me ç'rast 1 euro është e barabartë me 61 denarë) për 17 komuna të tilla. KSHZ-ja për herë të parë e mori përsipër që t'i transferojë këto mjete, mirëpo kapaciteti i saj për këtë ishte i pamjaftueshëm.

¹¹ KZK-të në Haraçinë, Demir Kapi, Konçe dhe Pllasnicë kishin pajisje joadekuate. KZK-të në Gazi Babë, Gjevgjeli, Radovish, Tearcë dhe Zhelinë kishin hapësira joadekuate të zyrës. KZK-të në Bogovinë, Bërvenicë, Tearcë, Vrapçisht dhe Zhelinë kishin mungesë të fondeve.

¹² Shtatë KZK kishin më pak se 30 për qind anëtare gra, ndërsa 6 kishin më pak se 30 qind anëtarë burra.

¹³ Paragrafi 7.3 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990](#) kërkon nga Shtetet pjesëmarrëse “ta garantojnë në mënyrë universale dhe të barabartë të drejtën e votës për qytetarët e rritur”. Marrja e të drejtës së votes në bazë të paaftësisë mendore dhe intelektuale nuk është në përputhje me Nenin 12 dhe atë 29 të KDPP-së. Paragrafi 9.4 i [Komunikatës nr. 4/2011 të Komisionit të KDPP-së të vitit 2013](#) (*Zsold Bujdosos dhe pesë të tjerë kundër Hungarisë*) i cili thotë se: “heqja e të drejtës së votës në bazë të paaftësisë së paramenduar ose faktike psikologjike ose intelektuale, duke e përfshirë edhe kufizimin në bazë të vendimit të individualizuar, paraqet diskriminim në bazë të paaftësisë”.

¹⁴ Shih [Rekomandimin e Kongresit \(CG/2015\(28\)6](#)) për kërkesat për vendbanim për zgjedhjet lokale.

¹⁵ Ministria për Punë të Brendshme (MPB) informon për ndryshimet e vendbanimeve dhe regjistrin e dokumenteve për identifikim. Gjykatat themelore ofrojnë të dhëna të përditësuara për personat të cilëve u janë marrë të drejtat ligjore.

¹⁶ Sidoqoftë, KSHZ-ja e informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se në bazë të shënimeve të pranuar nga MPB-ja, 7,007 njerëz që nuk kanë adresë të paraqitur dhe dikur rreth 600 njerëz me “adresë të panjohur” nuk gjenden në listat zgjedhore.

¹⁷ Gjatë këqyrjes publike, 203.191 votues i kanë kontrolluar të dhënat e tyre onlajn dhe 21,594 në zyrat rajonale të KSHZ-së. Ka pasur 133 kërkesa për korrigjim të të dhënave, 65 njerëz janë shtuar në listë, 22 janë larguar për shkak të vdekjes dhe 10 kërkesa të natyrave të tjera.

edhe nga ana e partive politike.¹⁸ Si rezultat i kësaj, shumë bashkëbisedues të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it shprehën besim të shtuar në integritetin e regjistrimit të votuesve, ndërsa disa të tjerë vazhduan të shprehin shqetësim, duke përfshirë edhe implementimin e kërkesës për vendbanim.

Për këto zgjedhje janë regjistruar gjithsej 1.814.644 votues. KSHZ-ja i miratoi listat përfundimtare të votuesve më 25 shtator, një ditë pas afatit të fundit zyrtar. Listat e shtypura të votuesve iu dërguan KZK-ve, të cilat pastaj iu dorëzuan KZ-ve më 13 tetor.

Regjistrimi i kandidatëve

Çdo votues me të drejtë vote që banon në komunën përkatëse mund të kandidojë në zgjedhje, përveç atyre që janë në burg ose atyre që janë në pritje të vuajtjes së dënimit me burg në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj. Partitë e regjistruara, koalicionet dhe grupet e votuesve kanë të drejtë të emërojnë kandidatë. Këta të fundit emërimin e tyre duhet ta mbështesin me nënshkrime prej 0.2 deri në 4.8 për qind të votuesve me të drejtë vote që banojnë në komunën përkatëse.¹⁹ Një votues mund të nënshkruajë për të mbështetur më tepër se një kandidat ose listë me kandidatë. Megjithatë, nënshkrimet duhet të mbledhen në prani të përfaqësuesit të KSHZ-së.

Pas një procesi inkluziv të regjistrimit, 19 parti dhe koalicione dhe 65 grupe votuesish, paraqitën gjithsej 370 lista për këshillat komunalë dhe 258 kandidatë për kryetarë të komunave, duke përfshirë edhe 19 kandidatë të pavarur.²⁰ Listat e kandidatëve u publikuan më 25 shtator dhe u ekspozuan në zyrat e KZK-ve, duke u mundësuar votuesve që të njoftohen me kandidatët e mundshëm. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it ka njohuri për refuzimin e pesë listave me kandidatë, për të cilat u parashtruan ankesa deri te Gjykata Administrative, e cila i refuzoi ato.²¹ Në kundërshtim me KZ-në, KSHZ-ja organizoi dy shorte për renditjen e kandidatëve në fletëvotim, një për partitë dhe koalicionet, dhe tjetrën për grupet e votuesve. Këta të fundit u vendosën në fund të listës.

Për ta përmirësuar barazinë gjinore, KZ-ja kërkon që në listat e kandidatëve të përfshihen jo më pak se 40 për qind e gjinisë më pak të përfaqësuar. Poashtu, një në çdo vend të tretë, plus një në çdo vend të dhjetë duhet të jetë për gjininë më pak të përfaqësuar. Megjithatë, këto kërkesa u dëmtuan nga një rregull e KSHZ-së.²² Nga kandidatët për kryetarë të komunave, 16 janë gra (6 për qind) dhe 14 për qind e listave për këshillat komunalë udhëhiqen nga gratë. KZK-të kanë regjistruar 9 lista me më pak se 40 për qind kandidatë gra dhe 17 lista në të cilat gratë nuk kanë qenë të vendosura në vendet e duhura.²³ KZK-të kompetente këtë mosrespektim të rregullave ia përshkruan gabimeve gjatë mbikëqyrjes dhe atyre aritmetike. Megjithatë, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u informua se një KZK që ka pranuar një listë me më pak kandidatë meshkuj se sa që duhet, ka kërkuar që ajo të korrigjohet. Nuk kishte mundësi të kërkohej mjete ligjore kundër listave të miratuara.

¹⁸ Partitë kërkuan shtimin ose fshirjen e gjithsej 49 votuesve. Kërkesat për shtim u pranuan, ndërsa ato për fshirje u refuzuan nga KSHZ-ja, për shkak se këto ndryshime janë në kompetencë të MPB-së, e jo të KSHZ-së.

¹⁹ Sipas KZ-së, numri i nënshkrimeve të nevojshme llogaritet në bazë të numrit të votuesve për çdo komunë, që ndryshon prej 100 deri në 1.000. Seksioni I.1.3.ii i Kodit për praktikë të mirë rekomandon që nënshkrimet për mbështetje të kandidatit ose të listës të mos e tejkalojnë një përqindëshin e votuesve të regjistruar.

²⁰ Dy subjekte të ndryshme politike, me logon dhe emrin e njëjtë, Aleanca për Shqiptarët, garuan kundër njëra tjetrës si parti dhe si koalicion. Ankesa nga partia për këtë çështje u refuzua për shkak se kjo nuk është e ndaluar me ligj.

²¹ Tre nga pesë listat u çregjistruan, për shkak se nuk kishin hapur llogari të veçantë bankare brenda afatit ligjor.

²² Rregulla u ndryshua pas kërkesave të bëra nga partitë, pas afatit të fundit për emërim. Ajo parasheh se në komunat që kanë këshilla me 11 deri në 19 anëtarë, vendi më i poshtëm ku mund të vendoset gruaja është vendi i fundit.

²³ Sipas KSHZ-së, 11 lista nuk kishin grua në çdo vend të tretë; 6 nuk kishin një grua në çdo vend të dhjetë në listë.

Ambienti i fushatës

Fushata zyrtare filloi më 25 shtator dhe përfundoi në mesnatë të datës 13 tetor.²⁴ Në KZ fushata është e rregulluar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe në përgjithësi ofron kushte për terren të barabartë për garim, edhe pse kandidatëve të pavarur nuk u ofrohen kushte plotësisht të barabarta, si për shembull hapësirë e dedikuar për bilborde dhe mbulim mediatik. Ligji ka për qëllim t'i mbrojtë votuesit nga presioni i panevojshëm dhe ta parandalojë blerjen e votave. Kufizimet e ndryshme kanë për qëllim ta mbështesin ndarjen e shtetit nga partia, si dhe ta ndalojnë keqpërdorimin e burimeve administrative.²⁵

Para fushatës zyrtare, qeveria e miratoi Deklaratën për zgjedhjet e lira dhe të drejta, duke i bërë thirrje publikut dhe zyrtarëve shtetërorë që të përmbahen nga aktivitetet mashtruese dhe ta respektojnë të drejtën e votuesve që të zgjedhin në mënyrë të lirë. Më 24 shtator në KSHZ dhe nëpër KZK-të, shumica e kandidatëve për kryetarë të komunave e nënshkruan Kodin e sjelljes duke premtuar se do ta respektojnë ligjin.

Fushata u zhvillua në një ambient ku liritë fundamentale për tubim dhe liria e shprehjes u respektuan në përgjithësi. Votuesve iu ofruan një varg mundësish për të zgjedhur, dhe në shumë komuna pati numër të madh të garuesve. Fushatat filluan me tubime festive, ku liderët e partive i prezantuan kandidatët e tyre, i zbuluan sloganet e fushatës dhe i paraqitën platformat e politikave të tyre.²⁶

Katër partitë më të mëdha mbajtën tubime në qendrat administrative, mirëpo u mbështetën edhe në vizitat derë-më-derë dhe në takimet e përmasave të vogla. Partitë më të vogla dhe kandidatët e pavarur zhvilluan fushata modeste ku i prezantuan vizionet e tyre për zhvillimin lokal. Një numër i partive të vogla iu ankuan MVZ-së së OSBE/ODIHR-it për mungesën e terrenit të barabartë gjatë zhvillimit të fushatës. Në përgjithësi, bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it theksuan në vazhdimësi se ka përmirësim në ambientin e fushatës dhe në zhvillimin e saj.

Strategjitë për fushatat lokale u përgatitën në nivel qendror, ndërsa u implementuan në nivel lokal. Partitë më të mëdha bënë fushatë për çështjet shtetërore të stabilitetit dhe të integritetit, dhe i ndërlidhën ato me çështjet lokale të ujit, higjienës publike dhe infrastrukturës. VMRO-DPMNE-ja, dhe në masë më të vogël, LSDM-ja, përdorën mesazhe negative gjatë tubimeve. Nga 25 shtatori, nëpër qendrat urbane u paraqitën bilborde të mëdha, ku kryesisht ishin të paraqitur kandidatët për kryetarë të komunave. Partitë, poashtu hapën edhe shtabe të përkohshme, ku u shpërndanë materialet për fushatë të përgatitura në qendër.

Gjatë tubimeve, kandidatet gra shpeshherë ishin në skenën kryesore, mirëpo rrallë folën. Poashtu, në kuadër të ekipeve për menaxhim të fushatës, gratë nuk kishin pozita udhëheqëse. Asnjëra nga partitë nuk i trajtoi çështjet që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e grave në jetën publike.²⁷

Më 19 shtator qeveria miratoi disa ligje me të cilat qytetarëve u mundësoi përfitime financiare dhe

²⁴ Për zhvillimin e fushatës para fillimit të saj zyrtar është paraparë gjobë e lartë.

²⁵ Dispozitat përfshijnë ndalesa për të bërë pagesa të cilat nuk janë paraparë në buxhet gjatë periudhës zgjedhore nga ana e qeverisë qendrore dhe nga komunat; inicimin e projekteve të reja për infrastrukturën publike ose inaugurimin e projekteve të infrastrukturës; si dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës ose punësimin e njerëzve të rinj në institucione shtetërore ose publike.

²⁶ Më 26 tetor, në tubimin fillestar të VMRO-DPMNE-së në Ohër, një anëtar i partisë hungareze në pushtet mbajti fjalim. Më 29 tetor, në Ohër, kryeministri i Hungarisë dhe ish-kryeministri i Sllovenisë mbajtën konferencë të përbashkët për shtyp me liderin e VMRO-DPMNE-së dhe kandidatët e kësaj partie për kryetarë të komunave.

²⁷ Vendimi i Këshillit të ministrave të OSBE-së nr.7/09 për Pjesëmarrjen e grave në jetën politike dhe atë publike u bën thirrje Shteteve të "sigurojnë masa të veçanta për arritjen e qëllimit për barazi gjinore në të gjitha organet legjislativë, gjyqësore dhe ekzekutive".

sociale.²⁸ Palët e interesuara të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it shprehën shqetësime në lidhje me blerjen e votave, frikësimin e votuesve, përdorimin e burimeve shtetërore për zhvillimin e fushatës dhe mjegullimin e ndarjes së shtetit nga partia; disa nga këto shqetësime ishin të besueshme.²⁹ Janë ngritur padi kundër dy kryetarëve aktualë të komunave për keqpërdorim të detyrës, duke përfshirë edhe shkelje që kanë të bëjnë me zgjedhjet.³⁰

Kishte incidente të izoluara, të motivuara politikisht, anembanë vendit, që përfshinin sulme ndaj shtabeve zgjedhore dhe dhunë ndaj një kandidati. Në Shuto Orizare, kandidati aktual për kryetar komune nga Unioni i Romëve të Maqedonisë (URM) u sulmua dhe u lëndua. Ky incident i nxori në shesh tensionet dhe nivelin e lartë të polarizimit brenda komunitetit rom.³¹

Financimi i fushatës

Rregulat për financimin e fushatës kanë pësuar ndryshime të konsiderueshme gjatë viteve të fundit, në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, Komisionit të Venedikut, dhe të Grupit të shteteve kundër korrupsionit të Këshillit të Evropës (GRECO). Megjithatë, disa rekomandime për ta avancuar edhe më tutje transparencën në financimin e fushatës mbeten të patrajuara, duke përfshirë edhe kërkesën për revizion të raporteve të përkohshme për financim të fushatës, si dhe kompetencat e avancuara për mbikëqyrje nga Enti shtetëror për revizion (ESHR).³²

Fushatat financohen nga anëtarësia partiake dhe donacionet private. KZ-ja i kufizon donacionet individuale, i përmend burimet e ndaluara dhe cakton limit për shpenzim gjatë fushatës.³³ Shpenzimet kompensohen pjesërisht nga administrata lokale për listat që fitojnë së paku 1.5 për qind të të gjitha votave të hedhura në një komunë. Transaksionet e fushatës duhet të realizohen nëpërmjet llogarisë së veçantë bankare për këtë qëllim.

ESHR-ja bën mbikëqyrje të financimit të fushatës. Para ditës së zgjedhjeve, ajo duhet të pranojë dy raporte të përkohshme për financimin e fushatës nga garuesit në zgjedhje. Raportet përfundimtare

²⁸ Me ato ligje u rrit rroga minimale dhe u ofrua pagesë mujore për të papunësuarit për shkak të privatizimit të ndërmarrjeve me pronësi dominante shtetërore. Në bazë të Mendimit të KSHPK-së të datës 15 gusht, gjatë zgjedhjeve janë të ndaluara të gjitha shqyrtimet e ligjeve.

²⁹ Në Studeniçan, një parti u ofroi votuesve punësim në administratë, në Koçanë, një kandidat është nën hetime për blerje të votave, në Demir Kapi një votuesi i janë ofruar para për votën e tij. Në Çashkë, një zyrtar shtetëror u është kërcënuar familjeve se do t'i humbin përfitimet nga mbrojtja sociale. Një rast i ngjashëm ndodhi në Koçanë ndaj një familjeje rome. Projekte të infrastrukturës janë iniciuar në një numër komunash gjatë periudhës zgjedhore. Në Demir Kapi, një shpallje e qeverisë u bënte thirrje qytetarëve të interesohen për rreth 200 vende pune në një kompani private. Paragrafi 7.7. i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 kërkon nga Shtetet pjesëmarrëse "të sigurojnë se ligji dhe politika publike funksionojnë që të lejojnë që fushata politike të zhvillohet në atmosferë korrekte dhe të lirë, ku as dhuna, veprimi administrativ, e as frikësimi nuk i pengon partitë dhe kandidatët që t'i shprehin lirshëm pikëpamjet dhe kualifikimet e tyre, dhe nuk i pengon votuesit që të mësojnë apo të diskutojnë për to, apo ta hedhin votën e tyre pa u frikësuar nga hakmarrja". Shih poashtu [Udhëzimet e përbashkëta të OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venedikut për parandalimin e dhe reagimin ndaj keqpërdorimit të burimeve administrative gjatë proceseve zgjedhore](#) të vitit 2016.

³⁰ Më 21 shtator u ngrit padi kundër kryetarit të komunës së Shtipit. Më 26 shtator, kryetari i komunës së Novo Sellës u padit për keqpërdorimin e detyrës për gjoja shpërndarjen e materialeve të fushatës duke e përdorur veturën zyrtare.

³¹ Partia në pushtet në Shuto Orizare, URM-ja, është aleat tradicional i VMRO-DPMNE-së. Bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it theksuan se ndryshimi i qeverisë e dobësoi pozitën e URM-së në nivel lokal dhe e ngriti besimin e kundërshtarëve të tyre, në veçanti të kandidatit të LSDM-së. Edhe pse jo për zënkë që ka të bëjë me zgjedhjet, një kandidat u vra në një incident në Kërçovë. Incidentet e tjera përfshijnë tentimin për ta spërkatur me sprej ish-kryeministrin nga radhët e VMRO-DPMNE-së, si dhe vandalizimin e së paku 10 shtabeve zgjedhore të BESËS, BDI-së, LSDM-së dhe VMRO-DPMNE-së.

³² Shih [Raportin e dytë për harmonizim nga rrethi i tretë i vlerësimit të GRECO-s](#) të vitit 2014.

³³ Donacionet nuk duhet ta kalojnë vlerën prej 3.000 eurosh (për individë) dhe 30.000 euro (për subjektet juridike), duke i përfshirë edhe kontributet në natyrë. Limiti për shpenzim në fushatë është 1.8 euro për kokë të votuesve të regjistruar në komunë, për çdo rreth zgjedhor. Këto vlera në KZ janë shënuar në euro.

dorëzohen në afat prej katër muajsh pas zgjedhjeve dhe ESHR-ja duhet të bëjë revizion të tyre. Mandati dhe burimet e kufizuara të ESHR-së për t'i analizuar këto raporte nuk mundësojnë që të përmbushen kërkesat për transparencë dhe llogaridhënie siç parashohin obligimet dhe standradet ndërkombëtare.³⁴ ESHR-ja ka kompetencë për të vepruar në lidhje me parregullsitë, qoftë me iniciativë të veten apo në bazë të ankesës; nuk janë raportuar raste të tilla.

U dorëzuan vetëm një përqindje e vogël e raporteve të përkohshme, dhe shumë garues përdorën shabllon të vjetëruar ose nuk i kanë ndarë shpenzimet në detaje, siç kërkohet me formatin e ri.³⁵ Raportet e përkohshme u publikuan onlajn nga ana e KSHZ-së.³⁶ Në tre raste, shpenzimet ishin më të larta se sa të hyrat.³⁷ Për më tepër, shpenzimet nuk ishin ndarë sipas komunave, gjë që e pengon mundësinë për të konstatuar se a janë respektuar kufizimet për shpenzime.

Mediat

Ambienti mediatik që karakterizohet me një numër të madh të operatorëve që veprojnë në një treg relativisht të vogël, përfshin 170 media. Televizioni është burimi kryesor i informimit, qarkullimi i gazetave është i vogël, ndërsa depërtimi gjithnjë e më i madh i internetit ka mundësuar zhvillimin e dukshëm të ueb-faqeve me lajme. Në përgjithësi, mediat janë të ndara në baza politike.

Sipas bashkëbiseduesve të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it akoma ka shqetësime për standardet e ulëta profesionale në një numër mediash që e dëmton të drejtën e publikut për të fituar raportim objektiv dhe të balancuar.³⁸

Kushtetuta e garanton lirinë e të shprehurit dhe e ndalon censurimin. KZ-ja parasheh që të gjitha mediat, duke i përfshirë edhe ueb-faqet, t'i mbulojnë zgjedhjet në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme. Mbulimi i zgjedhjeve në lajmet e transmetuesit publik, Radiotelevizionit të Maqedonisë (RTM) është i rregulluar në mënyrë të rreptë, ashtu siç është rregulluar edhe reklamimi i paguar në mediat private.³⁹ Megjithatë, KZ-ja nuk parasheh në mënyrë eksplicite që të ketë mbulim të drejtë për kandidatët e pavarur.

Respektimi i ligjeve nga ana e mediave monitorohet nga Agjencia për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike (ASHAM), e cila mund të shqiptojë sanksione dhe mund ta përcjellë çështjen në gjykatën kompetente. ASHAM-i ka bërë monitorim sistematik të mediave dhe raportet i ka publikuar rregullisht. ASHAM-i inicioi gjashtë procedura kundërvajtëse për shkelje që kanë të bëjnë me reklamimin e paguar politik, raportim jo të balancuar dhe publikim të anketave zgjedhore.⁴⁰

³⁴ Neni 7(3) i [Konventës kundër korrupsionit të KB-ve rekomandon](#) që “çdo Shtet poashtu duhet të konsiderojë konsiderojnë marrjen e masave të duhura legjislative dhe administrative [...] për ta rritur transparencën në financimin e kandidaturave për postet e zgjedhura publike dhe kur është e mundur edhe për financimin e partive politike”. Shih poashtu paragrafet 201-206 të [Udhëzimeve të OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venedikut për rregullat për partitë politike](#) të vitit 2011.

³⁵ Më 1 shtator, Ministria e Financave e miratoi një shabllon të ri të detajuar për raportet për financimin e fushatës.

³⁶ KSHPK-ja dhe ESHR-ja poashtu duhej t'i publikojnë raportet, dhe e bënë këtë, mirëpo me vonesë.

³⁷ Nga 15 raportet e para të përkohshme nga kandidatët e pavarur, 10 raportuan se nuk kanë pasur të hyra. ASH-ja, BESA, PDSH-ja, BDI-ja dhe “Levica” raportuan më tepër shpenzime se sa të hyra.

³⁸ Me ndryshimet e vitit 2015 dhe 2016 të KZ-së u trajtuan disa shqetësime, mirëpo reformat kyçe mediatike akoma nuk janë implementuar.

³⁹ Në kuadër të RTM-së veprojnë TVM1, TVM2. RTM-ja duhet t'ia kushtojë 30 për qind të edicioneve të saj ditore të lajmeve aktiviteteve të fushatës së partive në pushtet, 30 për qind partive opozitare dhe 10 për qind për të gjitha partitë joparlamentare së bashku. Në mediat private radiodifuzive, secila nga partitë në pushtet dhe ato opozitare mund të blejnë deri në tetë minuta brenda një ore; ndërsa secila nga partitë e tjera parlamentare dhe joparlamentare është e kufizuar deri në një minutë brenda një ore.

⁴⁰ ASHAM-i filloi procedura kundërvajtëse kundër *TV Alsat-M*, *TV Nova* dhe *TV 24 Vesti*, *TV 21*, *TV Star* dhe *TV Alfa*.

Rezultatet nga monitorimi i mediave nga ana MVZ-së së OSBE/ODIHR-it treguan se, siç është paraparë me KZ-në, transmetuesi publik u ofroi të gjithë garuesve minutazh pa pagesë në periudhën me shikim më të madh.⁴¹ Megjithatë, vetëm 26 kandidatë e shfrytëzuan këtë mundësi në TVM1. Kandidatët shqipfolës nuk kërkuan aspak minutazh pa pagesë në TVM2.

Në lajmet e RTM-së partitë më të vogla dhe kandidatët e pavarur ishin në pozitë jo të barabartë, duke e kufizuar kështu qasjen e votuesve në informata. Në TVM1, LSDM-ja kishte mbulim prej 37 për qind, VMRO-DPMNE-ja 32 për qind, BDI-ja 11 për qind dhe BESA 7 për qind. Të gjitha partive të tjera parlamentare iu kushtuan gjithsej 9 për qind të mbulimit mediatik, partive joparlamentare 3 për qind dhe kandidatëve të pavarur 1 për qind. TVM2 u kushtoi më tepër kohë partive të shqiptarëve etnikë.

Mediat private ofruan mbulim dominant të koalicionit të udhëhequr nga LSDM-ja për shkak të reklamave të paguara. LSDM-ja kishte mbulim prej 47 për qind, e ndjekur nga VMRO-DPMNE-ja me 29 për qind dhe BDI-ja me 17 për qind. LSDM-ja emetoi reklama me porosi negative gjatë gjithë fushatës. Në përgjithësi, mediat elektronike private që u monitoruan demonstuan një ton relativisht neutral ndaj kandidatëve në mbulimet e tyre redaktuese.

Edhe mediat radiodifuzive publike edhe ato private organizuan debate ndërmjet kandidatëve për kryetarë të komunave në komunat e tyre përkatëse dhe në studion e RTM-së në Shkup. Debatet ishin të organizuara mirë, megjithatë, rezultatet nga monitorimi i mediave nga ana e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it treguan se një numër i madh i kandidatëve të ftuar të VMRO-DPMNE-së nuk morën pjesë në to.

Mediat sociale u përdorën gjerësisht në fushatë. Një numër i madh i kandidatëve hapën faqe zyrtare për fushatë në Facebook. Në përgjithësi, kandidatët nga partitë më të mëdha, veçanërisht nga VMRO-DPMNE-ja, i përdorën mediat sociale më shpesh se sa partitë e tjera dhe kandidatët e pavarur.

Ankesat dhe apelimet

KSHZ-ja, KSHPK-ja, ESHR-ja dhe Gjykata administrative gjykojnë për ankesat dhe apelimet e ndryshme që kanë të bëjnë me zgjedhjet, ndërsa gjykatat themelore kanë kompetencë për rastet civile dhe ato penale.⁴² Një numër i bashkëbiseduesve i informuan vëzhguesit ndërkombëtarë se kishin mungesë të besimit në aftësinë e administratës zgjedhore dhe të gjykatave për t'i shqyrtuar në mënyrë të paanshme rastet që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Pesë gjykatës të Gjykatës Administrative, ndaj të cilëve është ngritur akt padi për keqpërdorim të detyrës gjatë shqyrtimit të një ankese kyçe në zgjedhjet lokale të vitit 2013, vazhduan t'i shqyrtojnë ankesat dhe apelimet në këto zgjedhje, që kontribuoi në perceptimin se ka njëanshmëri.⁴³ Transparenca është zvogëluar me faktin se Gjykata Administrative ka mbajtur mbledhje të mbyllura.⁴⁴

⁴¹ Monitorimi i mediave nga ana e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it u realizua prej 21 shtatorit deri më 15 tetor, dhe përfshinte monitorim sasior dhe cilësor të mbulimit të çështjeve që lidhen me zgjedhjet të gjashtë kanaleve kryesore televizive: *TVM-1, TVM-2, Sitel, Kanal 5, Telma, Alsat-M* dhe të katër gazetave të përditshme: *Nova Makedonija, Sloboden Pecat, Veçer dhe Koha*.

⁴² Ligji parashihet kompetencë për KZK-të që të marrin vendime për ankesat, mirëpo nuk përcakton asnjë lloj të veçantë të ankesave që janë në kompetencë të tyre; në praktikë KZK-të nuk i shqyrtojnë ankesat.

⁴³ Si masë parandaluese, Prokuroria speciale publike (PSP) kërkoi nga gjykata themelore që t'ua ndalojë pesë gjykatësve të gjykojnë në rastet që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Megjithatë, kërkesa u refuzua. Kryetari i Gjykatës Administrative e informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se ai nuk kishte kompetencë që t'i tërheqë gjykatësit nga këto raste.

⁴⁴ Paragrafi 12 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 thekson se “seancat mund të jenë të mbyllura (‘in camera’), në kushte të parapara me ligj dhe në përputhje me detyrimet sipas ligjeve ndërkombëtare dhe angazhimeve ndërkombëtare”. Shih poashtu Nenin 14 të [Koneventës ndërkombëtare për të drejtat qytetare dhe politike](#) (KNDQP).

KZ-ja ofron një kornizë të kufizuar për mjetet efektive ligjore për kontestet zgjedhore. Edhe pse disa vendime të KSHZ-së dhe të KZK-ve i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor, shumica e vendimeve nuk i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor, dhe për këtë arsye një numër i rëndësishëm i aspekteve të procesit zgjedhor janë në kompetencë përfundimtare të administratës zgjedhore, që është në kundërshtim me përkushtimet e OSBE-së dhe me praktikën e mirë ndërkombëtare.⁴⁵ Palët e interesuara kanë të drejta të kufizuara për të kërkuar mjete ligjore për shkeljet që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore, që poashtu është në kundërshtim me obligimet ndërkombëtare.⁴⁶ Votuesit dhe grupet qytetare kanë të drejta të kufizuara për t'i kontestuar parregullsitë dhe nuk mund t'i apelojnë rezultatet zgjedhore.⁴⁷

Deri në ditën e zgjedhjeve, KSHZ-ja pranoi vetëm disa ankesa që është në kompetencën e saj të kufizuar.⁴⁸ Edhe pse bashkëbisedues të ndryshëm të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it shprehën shqetësime për keqpërdorimin e burimeve administrative gjatë fushatës, blerjen e votave dhe presionin ndaj votuese, vetëm një numër shumë i vogël i ankesave të tilla u parashtruan në KSHPK, disa nga të cilat janë duke u shqyrtuar.⁴⁹ Posaçërisht, autoriteti i KSHPK-së u dëmtua nga Kuvendi kur e shkarkoi Prokurorin publik më 17 gusht, edhe pse vendimi i tillë ishte në kundërshtim me KZ-në.⁵⁰

Pjesëmarrja e pakicave kombëtare

Edhe pse marrëdhëniet ndëretnike luajnë rol në zgjedhje, ato nuk u përdorën dukshëm në fushatë.⁵¹ Kandidatët dhe listat tentojnë ta pasqyrojnë përbërjen etnike të komunës. Megjithatë, në disa raste, ata kanë kërkuar të fitojnë vota përtej kufijve etnikë. Në komunat me shumicë etnike shqiptare, disa parti etnike shqiptare që janë pjesë e koalicionit në pushtet, garuan kundër njëra tjetrës, duke përfshirë edhe kandidatë me profil të lartë.⁵²

Partitë që i përfaqësojnë bashkësitë më të vogla etnike kanë paraqitur kandidatë për kryetarë të komunave vetëm në raste të pakta, atje ku këto grupe etnike janë të koncentruara, duke i përfshirë turqit në Qendrën e Zhupës dhe romët në Shuto Orizare. Në vendet e tjera, bashkësitë më të vogla paraqitën lista me kandidatë për këshillat komunalë ose me partitë që i përfaqësojnë këto bashkësi ose si anëtarë të koalicioneve më të mëdha. Partitë më të vogla iu ankuan MVZ-së së OSBE/ODHIR-it se nuk kanë anëtarë të tyre në KSHZ dhe se nuk janë të përfaqësuar sa duhet në administratën zgjedhore lokale.

⁴⁵ Paragrafi 5.10 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 parasheh se “çdokush do të ketë mjete efektive juridike ndaj vendimeve administrative, për ta garantuar respektimin e të drejtave fundamentale dhe për ta siguruar integritetin ligjor”. Shih poashtu Rekomandimin [Rec\(2004\)20](#) të Këshillit të ministrave të Këshillit të Evropës për shqyrtimin gjyqësor të akteve administrative. Kodi i praktikës së mirë thekson se “Organi i ankimit për çështje zgjedhore duhet të jetë ose një komision zgjedhor ose gjykata. Në çdo rast, duhet të jetë i mundur ankimi përfundimtar në gjykatë.”

⁴⁶ Neni 2.3(a) i KNDQP-së i obligon shtetet që “të sigurojnë se çdo person, të drejtat ose liritë e të cilit, që janë të njohura këtu, janë shkelur, duhet të ketë mjet efektiv ligjor, pavarësisht nga ajo se shkelja është bërë nga personat që vepruar në kapacitet zyrtar”.

⁴⁷ Seksioni II.3.3. i Kodit të praktikës së mirë thekson se “tagri për apelim duhet të jetë sa më i gjerë që të jetë e mundur... Megjithatë, për apeline nga votues për rezultatet e zgjedhjeve mund të vendoset një kuorum i arsyeshëm.

⁴⁸ Ajo i shqyrtoi nëntë ankesa në lidhje me mohimin e të drejtës për të votuar në shtëpi, duke i shfuqizuar vendimet e KZK-ve.

⁴⁹ Përveç 15 ankesave në lidhje me shkarkimin nga puna të nëpunësve publikë gjatë periudhës zgjedhore, KSHPK-ja pranoi pesë ankesa për fillimin e projekteve infrastrukturore dhe përdorimin e burimeve administrative për fushatë nga një kryetar aktual i komunës.

⁵⁰ Mendimi i KSHPK-së për këtë çështje u miratua më 15 gusht, në bazë të kërkesës së katër deputetëve të VMRO-DPMNE-së.

⁵¹ Në bazë të regjistrimit të fundit të popullsisë të vitit 2002, 64.18 për qind u deklaruan si maqedonas etnikë, 25.17 për qind si shqiptarë etnikë, 3.85 për qind si turq etnikë, 2.66 për qind si romë etnikë, 1.78 për qind si serbë etnikë, 0.84 për qind si boshnjakë etnikë, 0.48 si vllahë etnikë dhe 1.04 për qind si të tjerë.

⁵² Për shembull në Gostivar, ministri i shëndetësisë i ASH-së garoi kundër kryetarit aktual të komunës nga radhët e BDI-së dhe në Strugë, ku kryetarit komunal nga radhët e ASH-së iu kundërvu kandidati i BDI-së, i cili ka qenë kryetar i mëparshëm i komunës.

Në zonat ku jetojnë pakicat, atmosfera ishte e qetë, ndërsa retorikë e fortë dhe konfrontuese u vërejt në kandidatët që i përkasin bashkësisë së njëjtë, si për shembull ndërmjet kandidatëve etnikë shqiptarë në Strugë. Mediat shtetërore u kushtuan shumë pak minutazh dhe hapësirë kandidatëve që i përfaqësojnë bashkësitë më të vogla dhe temat që ishin me rëndësi për ta u mbuluan në mënyrë të kufizuar.

Vëzhguesit qytetarë dhe ndërkombëtarë

KZ-ja parasheh që vëzhguesit qytetarë dhe ata ndërkombëtarë të kenë qasje në të gjitha fazat e procesit zgjedhor dhe Kodi i sjelljes i KSHZ-së, që është i detyrueshëm, parasheh paanshmëri dhe mosndërhyrje në procesin zgjedhor. Në një proces të organizuar në kohë dhe inkluziv, KSHZ-ja akreditoi 6 organizata vëzhguese qytetare dhe 24 organizata vëzhguese ndërkombëtare, duke kontribuar në këtë mënyrë për transparencën e procesit zgjedhor. Vëzhguesit qytetarë i vlerësuan përgatitjet për zgjedhje dhe zhvillimin e fushatës anembanë vendit, gjë që ofroi një vlerësim jopartiak të zgjedhjeve. Poashtu, u organizua edhe një iniciativë qytetare për t'u ndihmuar personave me pengesa për ta ushtruar të drejtën e tyre të votës. Për ditën e zgjedhjeve, KSHZ-ja akreditoi 3.000 vëzhgues qytetarë; 2.800 nga MOST-i dhe 200 nga CIVIL-i. Garuesit poashtu akredituan përfaqësues të tyre.

Dita e zgjedhjeve

Votimi i hershëm dhe dita e zgjedhjeve kaluan në mënyrë të rregullt në pjesën më të madhe të vendit. Megjithatë, u vërejtën disa parregullsi procedurale, në veçanti gjatë numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve. Policia inicoi shtatë procedura për gjoja blerje votave në pesë komuna. Tre prej tyre u përcollën për ndjekje penale⁵³. Transparenca u avancua me praninë e vëzhguesve partiakë dhe atyre qytetarë në 76 dhe 55 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, respektivisht.

Votuesit në shtëpi votuan më 14 tetor.⁵⁴ Kjo u vlerësua negativisht në 14 nga 96 rastet e vëzhguara. Fshehtësia e votës u komprometua në 13 raste, ndërsa në 7 raste, KZ-të nuk e shfrytëzuan kabinën e votimit. Në disa burgje, të burgosurit nuk ishin përfshirë në listat zgjedhore për shkak se nuk kishin letërnjoftime të vlefshme.

Hapja e vendvotimeve u vlerësua nga vëzhguesit ndërkombëtarë si e mirë ose shumë e mirë në 75 nga 82 vendvotime të vëzhguara. Shumica e vendvotimeve u hapën në kohë ose me një vonesë shumë të vogël dhe me parregullsi shumë të vogla procedurale. Në 14 raste, protokollet nuk u plotësuan para hapjes së vendvotimit, dhe në 5 raste u vërejt se vëzhguesit partiakë ndërhyjnë në proces.

Votimi u vlerësua pozitivisht në 94 për qind të vendvotimeve të vëzhguara. Parregullsitë më të shpeshta përfshinin votim familjar/grupor dhe votim në emër të dikujt tjetër (8 dhe 2 për qind, respektivisht), kuti të votimit të mbyllura në mënyrë joadekuate (2 për qind) dhe tentime për të ndikuar në zgjedhjen e votuesit (1 për qind). Organizimi i hapësirës së vendvotimeve nuk mundësoi mbrojtje të mjaftueshme të fshehtësisë së votës në 2 për qind të vendvotimeve të vëzhguara. KSHZ-ja pranoi kërkesa nga më shumë se 10 KZK për të marrë udhëzime se si të veprojnë në lidhje me parregullsitë.

Votuesit nuk mundën t'i gjejnë emrat e tyre në listat e votuesve në nëntë për qind të vendvotimeve të vëzhguara. KSHZ-ja pranoi mbi 45 ankesa në lidhje me mohimin e të drejtës së votës; shumica e tyre u refuzuan. Shabllon me alfabetin e Brajtit kishte në 8 për qind të vendvotimeve të vëzhguara dhe mbi dy të tretat e vendvotimeve të vëzhguara kishin kabinë për votim me qasje për karrocet invalidore.

⁵³ MPB-ja i informoi vëzhguesit ndërkombëtarë për rreth 122 raporte të pranuar në lidhje me raste që kanë të bëjnë me zgjedhjet.

⁵⁴ Sipas KSHZ-së, 5.025 votues në shtëpi, 1882 votues në burgje dhe 9 persona të zhvendosur në brendi të vendit u regjistruan për të votuar.

Numërimi u vlerësua si efikas dhe transparent në 69 prej 78 vendvotimeve të vëzhguara. Megjithatë, në 9 raste procedurat e parapara nuk u ndoqën, në 15 raste KZK-të nuk i anuluan në mënyrë adekuate fletëvotimet e pashfrytëzuara dhe nuk e caktuan numrin e votuesve që kanë votuar, në 11 raste persona të paautorizuar i numëruan votat. Në 12 raste, komisionet zgjedhore u përballën me vështirësi gjatë plotësimit të protokolleve.

Gjatë nxjerrjes së rezultateve, shumica e KZK-ve i ndoqën procedurat, në 65 nga 71 rastet e vëzhguara. Megjithatë, mangësitë në transparencë (3 raste), hapësira e pamjaftueshme (12 raste) dhe mosorganizimi (6 raste) e vonoi procesin në gjashtë KZK. Në 14 KZK, qasja e vëzhguesve ishte e kufizuar gjatë futjes së të dhënave, gjë që e kufizoi transparencën.

KSHZ-ja filloi t'i publikojë rezultatet preliminare një kohë të shkurtë pas mbylljes së vendvotimeve, që kontribuoi për transparencë, megjithatë rezultatet nuk ishin të ndara sipas vendvotimeve, që e kufizoi këqyrjen e tyre. KSHZ-ja njoftoi në mënyrë preliminare se përqindja e daljes në votime ishte 60 për qind.

INFORMATATA PËR MISIONIN DHE MIRËNJOHJE

Shkup, 16 tetor 2017 – Kjo Deklaratë për gjetjet dhe përfundimet është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) dhe të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës (Kongresi). Vlerësimi u bë që të caktohet se a u mbajtën zgjedhjet në përputhje me përkushtimet e OSBE-së, obligimet tjera ndërkombëtare dhe standardet për zgjedhje demokratike dhe me legjislacionin shtetëror.

Ambasadori Audrey Glover është shefi i Misionit për vëzhgimin e zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it, që filloi me punë më 13 shtator, ndërsa Karim Van Overmeire (Belgjikë) e udhëhoqi delegacionin e Kongresit.

Të dyja institucionet e përfshira në këtë Mision ndërkombëtar për vëzhgimin e zgjedhjeve e kanë miratuar Deklaratën e Parimeve për vëzhgimin ndërkombëtar të zgjedhjeve të vitit 2005. Kjo Deklaratë e gjeteve dhe përfundimeve është dorëzuar para se të përfundojë procesi zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve do të varet, pjesërisht, nga zhvillimi i fazave të mbetura të procesit zgjedhor, duke përfshirë nxjerrjen e rezultateve dhe trajtimin e ankesave dhe apelimeve të mundshme pas ditës së zgjedhjeve. OSBE/ODIHR-i do të publikojë një raport gjithëpërfshirës përfundimtar, duke përfshirë rekomandime për përmirësime eventuale, diku rreth 20 javë pas përfundimit të procesit zgjedhor. Kongresi do ta prezantojë raportin e tij në Sesionin e tij të 34 në mars të vitit 2018.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it përfshin 17 ekspertë në kryeqytet dhe 20 vëzhgues afatgjatë të shpërndarë në mbarë vendin.

Në ditën e zgjedhjeve, janë shpërndarë 208 vëzhgues, duke përfshirë edhe delegacionin 13 anëtarësh nga Kongresi, i cili përfshinte 12 vende anëtare të Këshillit të Evropës. Vëzhguesit e OSBE/ODIHR-it u siguruan nga 31 vende pjesëmarrëse të OSBE-së.

Vëzhguesit dëshirojnë t'i falënderojnë autoritetet e vendit nikoqir për ftesën për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve për ndihmën e tij. Ata poashtu dëshirojnë ta shprehin falënderimin e tyre edhe ndaj institucioneve të tjera shtetërore, partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare për bashkëpunimin e tyre.

Për informata plotësuese, ju lutemi kontaktoni:

- Ambasadorin Audruy Glover, Shef i MVZ-së së OSBE/ODIHR-it në Shkup, (+389 2 322 2558);
- Maria Kuchma, redaktore e ueb-faqes së OSBE/ODIHR-it, (+48 609 038 346) ose Tamara Otiashvili, Këshilltare për Zgjedhje në OSBE/ODIHR në Varshavë (+48 22 5200 680);
- Renate Zikmund, Shefe e departamentit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, në Strasburg (+33 659 786 455).

Adresa e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it

6 Nikolla Kljusev, 1000 Shkup

Tel: +389 2 3222 558, Faksi: +389 2 3226 776

E-mail: office@odhr.org.mk

Ueb-faqja: <http://www.osce.org/odhr/elections/fyrom/339261>

*Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar.
Janë siguruar edhe përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.*